

SHPREHJET FRAZELOGJIKE DHE FUNKSIONET E TYRE SINTAKSORE NË ROMANIN „KRONIKË NË GUR“ NGA ISMAIL KADARE

Nertila RAMADANI¹

^{1*} Department of Albanian Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova

^{*}Corresponding author e-mail: nertila.ramadani@unite.edu.mk

Abstract

The enrichment of language has always been sought and continues to be pursued by poets, prose writers, and authors. Through them, the Albanian language is not only enriched with new words but has also become a language of culture and science. The analysis of Ismail Kadare's works thus far has primarily focused on literary, stylistic, and aesthetic interpretations, while the linguistic approach to his novels has remained largely untouched and unstudied as a whole. Particularly notable is Kadare's mastery in the use of idiomatic expressions in language. This study explores the phraseological expressions found in Ismail Kadare's novel *Chronicle in Stone*, focusing on their syntactic functions and stylistic significance.

These units, idiomatic expressions, taken from the novel *Chronicle in Stone*, are illustrated in practical examples. The idiomatic expressions have been studied in terms of structure (morphological), syntax, and semantics, with particular emphasis on the syntactic aspect. By analyzing the syntactic roles of these expressions, such as verbal phrases, idiomatic constructions, and sentence structures, we aim to reveal how they contribute to character development, thematic depth, and the overall texture of the narrative. The findings indicate that Kadare's use of idioms serves not only artistic purposes but also reflects the cultural and social intricacies of Albanian society.

Keywords: *phraseology, idiomatic expressions, syntactic functions, stylistic analysis.*

Hyrje

Pasurimi i gjuhës gjithmonë është kërkuar dhe kërkohet ndër poetët, prozatorët, shkrimtarët. Përmes tyre gjuha shqipe jo vetëm që pasurohet me fjalë të reja, por është bërë edhe gjuhë kulture, shkence. Analiza e deritashme e veprave të Ismail Kadaresë kryesisht ka qenë e përqendruar në interpretimin letrar, stilistik, estetik, ndërkaq qasja gjuhësore e romaneve të autorit është lënë e paprekur, e pastudiuar në tërësi. Ky fakt më motivoi të bëj studimin e shprehjeve frazeologjike, me theks të veçantë përngjitjet frazeologjike (idiomat), në romanin monumental dhe autobiografik të ambasadorit të letërsisë shqipe në botë, “Kronikë në gur” të Ismail Kadaresë.

Në mënyrë të veçantë shquan mjeshtëria e Kadaresë në fushën e përdorimit të shprehjeve frazeologjike në gjuhë. Gjatë përdorimit të këtyre formave ai u përmbahet normave drejtshkrimore dhe gramatikore të shqipes së sotme, si pjesa më e madhe e krijuesve shqiptarë megjithatë kjo nuk e pengon aspak për të shprehur veçantitë e tij gjuhësore. Stili dhe shkrimi kadarean mund të vërehen që në rreshtat e para të romanit. Ky studim përmban hulumtimin e frazeologjisë së periudhës bashkëkohore, të shek. XX, të cilën Ismail Kadare e ka ndërtuar

përmes veprave të tij më të njohura. Frazeologjia është studiuar edhe si disiplinë e linguistikës, por edhe si formë e krijimit të shprehjeve të natyrshme në opusin krijues të autorit të lartpërmendur. Frazeologjizmat janë studiuar në aspektin e ndërtimit (morfologjik), sintaksor dhe semantik, me theks të veçantë në aspektin sintaksor.

Metodologjia

Ky studim është bazuar në metodën analitike, të bazuar në mbledhjen dhe klasifikimin e shprehjeve frazeologjike në romanin e lartpërmendur. Më konkretisht procesi ka përfshirë: përzgjedhjen e frazeologjizmave (shembuj praktikë nga romani) – duke identifikuar funksionin e tyre sintaksor dhe stilistik, veçimin në togfjalësja dhe shprehje idiomatike; kklasifikimin e shprehjeve sipas strukturës, funksionit sintaksor dhe kuptimit si dhe shpjegimin e tyre për të ilustruar rolin që bartin në fjali.

Vlera letrare e romanit „Kronikë në gur”

Një gjeneral, një kështjellë dhe një qytet prej guri ishin të mjaftueshme për një sukses të madh. Megjithatë, romani *“Kronikë në gur”* shërbeu si një hap i rëndësishëm që e vendosi krijimtarinë e autorit në një nivel të lartë, të dukshëm nga çdo këndvështrim artistik. “Mënyra si është trajtuar kjo periudhë në roman është shumë e veçantë, edhe pse ‘Kronikë në gur’ nuk tregon një periudhë të panjohur për letërsinë tonë. Fjala “kronikë” nuk mbetet në kuptimin e saj të mirëfilltë. ‘Kronikë në gur’ është një kronikë sa epiko -dramatike aq edhe liriko-filozofike, është një kronikë e madhe, e rëndë dhe e singertë e një jete të vështirë” (Abazi, 1978, f. 263).

Ka aty diçka madhore dhe intime, diçka të rëndë dhe krenare, diçka të dhimbshme e nostalgjike, por edhe frymëzuese; diçka të rëndë e të gurtë, në luhatje, tronditje dhe lëvizje, një botë në luftë dhe vuajtje, një botë prej guri dhe prej mishi që jeton dramën e saj. Dhe të gjitha këto janë dhënë me mjetet artistike të prozës e jo me gjuhën e kronikës e historisë. Historia ka hyrë në roman, diku mes kapitujve. Duke lexuar romanin *“Kronikë në gur”*, të forcohet mendimi se Kadareja, në perceptimin e realitetit për të cilin shkruan, interesohet për momentet sublime të jetës.

Me një fjalë, ai gjen këndin nga i cili i rrëmben realitetit atë material që ka një kuptim të madh politiko-shoqëror me shtrirje të gjerë kohore, pavarësisht nga koha e zhvillimit të ngjarjeve. Ky prozator nuk hyn në analiza, në zbërthime dhe përshkrime të hollësishme. Pak i intereson si është pushtuar qyteti i gurtë, si janë zhvilluar luftërat për ndërrimin e flamurëve në qytet, si është dashuruar me vajzën e Aqif Kashahut djali me flokë dhe sy të çelët, si i bën eksperimentet kirurgjikale me macet mësuesi Qani Kekezi, si hidhet në mal tezja e vogël e fëmijës, si vritet Argjir Argjiri apo si mundën të hynin në qytet partizanët. Gjithçka në vepër ka një rol dhe peshë relative: karakteret, figurat artistike, përshkrimet e autorit, monologët, ambienti e të tjerë komponentë, por asnjëri nuk është mbizotërues (Abazi, 1978, f. 264).

“Arkitektura e prozës së Kadaresë në përgjithësi i ngjan një mozaiku shumëngjyrësh. Linjat, ngjarjet, faktet, veprimet, episodet në prozën e tij janë si ngjyrat, tonet dhe detajet e kësaj tabloje sido që të shihen veç e veç, ato nuk mund të të japin atë që jep e gjithë tabloja!...” (Çaushi, 1993, f. 67). Në romanin *“Kronikë në gur”*, Kadare ka përdorur groteskun dhe humorin. Këta dy elemente sjellin larmi dhe freski në prozën e autorit.

Efekti i groteskut në një vepër letrare është i qartë kur përdoret me vend, në funksion të ideve. Kështu, për të dhënë efektin e jashtëzakonshëm që bëri në qytetin e lashtë bombardimi i ri, modern, nga qielli ku mendohej se ka vetëm engjëj dhe perëndi, autori kalon në përshkrim grotesk. Po kështu, duke ngritur në grotesk martesën e hermafroditit Argjir Argjiri, për të dhënë psikologjinë e vjetër të njerëzve, shprehet në gjuhën e mendimit të tyre: *“Sfida ishte e*

tmerrshme... Një dyshim i zi varej kudo... Qyteti u nxi... Daullja e dasmës binte pa pushim, sikur lajmëronte mbarimin e nderit të këtij qyteti... Kupa që mbushur, - kishte thënë Xhexhua. Tani, sipas saj, pritej dalja e ujit të zi... ” (Kadare, 2000, f. 105).

Kjo gjuhë do t'i duhet autorit edhe për tipizim e konkretizim të shumë aspekteve të tjera. Ky hiperbolizim do t'i duhet edhe kur do të përshkruajë plakat e jetës, eksperimentet e Qaniut dhe kërkimet e Dino Çiços. Në “Kronikë në gur” grotesku në radhë të parë është i mendimit, i idesë. Por në roman ka gjetur një vend të përshtatshëm dhe humori. Ai duhej të vinte doemos në këtë roman ku zënë vend të rëndësishëm bota e vjetër që vdes. Vdekjen e kësaj bote Kadareja e jep me nuancat e një humori të hollë që buron nga thellësia e përmbajtjes. Nuk ka këtu batuta e fraza të kërkuara, episode anekdotike etj.

Romani nuk ka mvëshje satirike, por e qeshura vjen e natyrshme, vjen nga koha që na ndan me atë botëkuptim, me ato koncepte të destinuara të vdesin. Në gjykimet dhe vlerësimet për një vepër, për komponentët dhe elementët e saj apo për stilin e autorit nuk duhet shprehur apriori, në bazë të disa dukurive të jashtme, pa u thelluar në esencën e tyre. Për veprat e Kadaresë shpesh janë dhënë përkufizime dhe mendime të shpejtuara, që janë rezultat i mungesës së njohurive letrare shkencore.

Idiomat

Fjala "idiomë" vjen nga greqishtja "idíōma," që nënkupton "tipar i veçantë," dhe kjo rrjedh nga "idios," që do të thotë "i veçantë." Në fjalorët e shqipes (1980 dhe 2002), termi "idiomë" përdoret me dy kuptime gjuhësore. Në kuptimin e parë është sinonim i termit njësi frazeologjike si *“shprehje me ndërtim të veçantë, tërësisht a pjesërisht të ngurosur, që përdoret në një gjuhë prej kohësh me kuptim të njësishtëm (i cili nuk del drejtpërdrejt nga shuma e kuptimeve të fjalëve përbërëse) dhe që nuk mund përkthehet fjalë për fjalë në gjuhë tjera”,* ndërsa në kuptimin e dytë ka domethënien *“fjalë e veçantë që përdoret në kuptim të figurshëm vetëm në një gjuhë e që nuk mund të përkthehet drejtpërdrejt në gjuhë të tjera (p.sh. pikë në kuptimin “mes”: në pikë të dimrit; gojëlidhuri euf. ujku etj.)”* (Akademia e Shkencave, 1980, f. 709)

Sipas J. Thomait (1981), idiomat janë grupe fjalësh të qëndrueshme, të cilat kanë marrë formën e tyre gjatë historisë dhe janë bërë njësi të pandashme, me kuptim që korrespondon me atë të një fjale të vetme. Njësitë frazeologjike të pamotivueshme quhen edhe përngjitje frazeologjike ose idioma. Idiomat frazeologjike më shumë se njësitë tjera frazeologjike shprehin veçantitë kombëtare të zhvillimit historik të gjuhës, ato nuk përkthehen në gjuhë të tjera fjalë për fjalë, pasi ndërtimi i brendshëm kuptimor është errësuar shumë e përgjithësisht janë të ngurosur edhe nga forma. (Thomai, 2011, f. 205)

Karakteristikat e idiomave

-Figurshmëria: Për një grup fjalësh që të konsiderohet idiomë dhe të marrë një kuptim të ri, është e nevojshme që të paktën një nga fjalët të humbasë fillimisht kuptimin e saj të zakonshëm. Kështu, fjalët që kanë humbur kuptimin e tyre origjinal përdoren në idiomë me një kuptim figurativ. Figurshmëria vjen si rezultat i ndryshimit të kuptimit të fjalëve nga kuptimi i tyre fillestar, duke krijuar një mospërputhje mes kontekstit origjinal dhe atij të ri.

Metafora gjuhësore: Një nga përkufizimet më të përgjithshme të metaforës është ajo si një procedurë gjuhësore, ku një term konkret përdoret në një kontekst abstrakt bazuar në ngjashmërinë mes tyre. Nëpërmjet metaforës, kuptimi i një fjale zgjerohet dhe përhapet te fjalë të tjera që kanë ngjashmëri me atë të parën.

Kufizimi morfo-sintaksor: Përbërësit e një idiome nuk mund të ndryshohen, as të shtohen ose të hiqen. Ato nuk mund të ndryshojnë rendin ose formën e tyre siç ndodh zakonisht me shprehjet. Gjithashtu, kur idiomat kanë formë foljore, nuk është gjithmonë e mundur t'i kthehen në formën pësore ose të tjera. Ndryshimi ose modifikimi i idiomave zakonisht çon në

humbjen e kuptimit ose i bën ato të zakonshme. Pra, kufizimet në idioma lidhen me sintaksën dhe morfologjinë.

Përdorimi i shprehjeve frazeologjike në romanin "Kronikë në gur"

Kadare, si mjeshtër i fjalës shqipe, i sheh njësitë frazeologjike si një mundësi e shkëlqyer për ta pasuruar dhe hijeshuar gjuhën e veprës së tij, për faktin se ato “i përkasin gjuhës së gjallë dhe kanë më shumë ngarkesë dhe figurshmëri.” Ky vlerësim pasqyrohet në numrin e madh dhe larmishmërinë e njësive frazeologjike. Njësia frazeologjike është përkufizuar si një grup fjalësh të qëndrueshme, të krijuara historikisht dhe të konsoliduara si një njësi e pandashme, që nga ana kuptimore është e barasvlershme me një fjalë të vetme.

Megjithatë, për të analizuar njësitë frazeologjike në një vepër letrare, është e rëndësishme të vlerësohen veçoritë e tyre dalluese, emocionuese, shprehëse dhe stilistike. Kur themi se një njësi frazeologjike është e barasvlershme me një fjalë, nënkuptojmë kuptimin e saj të përgjithshëm dhe kategorial, aftësinë për të shprehur diçka nga realiteti, dhe jo një përputhje të plotë në përmbajtjen konkrete dhe specifike.

Njësitë frazeologjike me karakter popullor përbëjnë pjesën më të madhe të frazeologjisë së përdorur nga Kadare. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se autori nuk kufizohet vetëm te frazeologjia krahinore, e cila identifikohet përmes elementëve dialektorë dhe krahinorë, por përdor edhe njësi frazeologjike me karakter kombëtar. Kjo lidhet me synimin dhe prirjen e tij drejt gjuhës kombëtare. Përmbushja e këtij qëllimi është rezultat i përmbajtjes së gjerë të veprës së tij, që reflekton identitetin e shumëfishtë të popullit shqiptar, si dhe i profilit të autorit si një njohës i thellë i gjuhës shqipe në tërësinë e saj.

Duke pasur parasysh pasurinë e madhe të gjuhës shqipe në fushën e frazeologjisë dhe mundësitë e shumta për të pasqyruar në mënyrë të nuancuar mendimet, ndjenjat, psikologjinë e personazheve dhe ambientet me një ndjeshmëri artistike të lartë, Kadare i përdor ato me densitet, cilësi dhe origjinalitet. Në vazhdim po japim disa shembuj të përdorimit të frazeologjizmave në roman:

Pa e mbledhur veten – pa ardhur në vete, pa u kthjelluar, pa e përmirësuar gjendjen mendore apo fizike (togfjalësh folje+përemër - funksioni sintaksor i kallëzuesit);

Merrte fund – përfundoi, mbaroi diçka (togfjalësh folje+emër - funksioni sintaksor i kallëzuesit);

Ua qaja hallin – u ankoheha, shprehja dhimbje ose shqetësim (togfjalësh folje+emër - funksioni sintaksor i kallëzuesit);

Vrisja mendjen – mendohesha fort, i lodh trutë për të zgjidhur ndonjë çështje të ngatërruar (togfjalësh folje+emër - funksioni sintaksor i kallëzuesit);

Nuk më vunë re – nuk më panë, nuk më kushtuan vëmendje (togfjalësh i pamotivueshëm - funksioni sintaksor i kallëzuesit);

E merrja me mend - e dija, e kuptoja, kisha ide për diçka (togfjalësh folje + emër - funksioni sintaksor i kallëzuesit);

M'u ngroh zemra – më pëlqeu, ndjeva ngrohtësi, kënaqësi emocionale (togfjalësh folje + emër - funksioni sintaksor i kallëzuesit);

Thashë se luajta nga mendja – u çmenda, e humba arsyen (shprehje frazeologjike me strukturë fjalie - funksioni sintaksor i kallëzuesit);

Na prish gjakun – na shqetëson, na turbullon, na krijon trazim emocional (togfjalësh folje + emër - funksioni sintaksor i kallëzuesit);

I bënte bisht goditjes – i ikte goditjes, i shmangej, i largohej, i dredhonte, e evitonte një situatë apo përgjegjësi (shprehje frazeologjike me strukturë fjalie - funksioni sintaksor i kallëzuesit);

Ishin të numëruara me gishta – ishin pak në numër (shprehje frazeologjike me strukturë fjalie - funksioni sintaksor i kallëzuesit emëror);

E mora vesh – e kuptova, e mësova diçka (togfjalësh i pamotivueshëm - funksioni sintaksor i kallëzuesit);

Ishte zhdukur sa hap e mbyll sytë – shumë shpejt (shprehje frazeologjike me strukturë fjalie - funksioni sintaksor i rrethanorit). Kjo shprehje përdor një hiperbolë (hap e mbyll sytë), për të përdorur idenë e shpejtësisë.

Ngulnin këmbë – këmbëngulnin, insistonin për ndonjë ide apo qëndrim (togfjalësh folje + emër - funksioni sintaksor i kallëzuesit). Në këtë shprehje fjala “këmbë” është përdorur si metaforë.

Ta ngrije zërin – të bërtisje, të shprehje pakënaqësi apo zemërim me një ton të ngritur (togfjalësh folje + emër - funksioni sintaksor i kallëzuesit);

Ia merrte kësaj kënge – ia niste këngës, fillonte të këndonte (togfjalësh folje + përemër + emër - funksioni sintaksor i kallëzuesit);

Më vinin ndër mend – i kujtoja (togfjalësh i pamotivueshëm - funksioni sintaksor i kallëzuesit);

E nxirrte nga goja – fliste, shprehej, thoshte diçka (togfjalësh folje + parafjalë + emër - funksioni sintaksor i kallëzuesit);

I ngula sytë – u përqendrova, shikoj me vëmendje (togfjalësh folje + emër - funksioni sintaksor i kallëzuesit);

Hidhet burri i botës – ngrihet burri i botës, reagon në papritur, në mënyrë të vullshme (togfjalësh folje + emër + emër - funksioni sintaksor i kallëzuesit);

Të sillja ndër mend – të kujtoja dikë apo diçka me qëllim ose spontanisht (togfjalësh i pamotivueshëm - funksioni sintaksor i kallëzuesit);

Një copë herë – pak kohë, një kohë të shkurtër, interval i shkurtër kohor (togfjalësh numëror + emër + emër, funksioni sintaksor i rrethanorit);

Ia plasi gazit – u shkri së qeshuri, qeshi me të madhe (togfjalësh folje + emër - funksioni sintaksor i kallëzuesit);

U shkri gazit – qeshi shumë, u kënaq (togfjalësh folje + emër - funksioni sintaksor i kallëzuesit);

S’kam zemër ta shoh – nuk mund të duroj, nuk kam fuqi emocionale për të përballuar diçka (shprehje frazeologjike me strukturë fjalie – funksioni sintaksor i kallëzuesit);

Ç’më zbardh dhembët – pse qesh, reagim i pakënaqur ndaj buzëqeshjes së dikujt, me nëntekst ironik (shprehje frazeologjike me strukturë fjalie – funksioni sintaksor i kallëzuesit);

Na vjen koka rrotull – s’dimë si t’ia bëjmë kësaj pune, kemi shumë halle, s’dimë nga t’ia mbajmë (shprehje frazeologjike me strukturë fjalie – funksioni sintaksor i kallëzuesit);

E vrisja mendjen – mendoja shumë, mendoja thellë për një çështje (togfjalësh folje + emër - funksioni sintaksor i kallëzuesit);

E mori lumi – e preu e zeza, e ka keq punën, gjendet në një situatë të pashpresë (togfjalësh folje + emër - funksioni sintaksor i kallëzuesit);

Fjalët i merr era – fjalët harrohen shpejt, shpesh nuk kanë ndikim (togfjalësh emër + folje + emër - funksioni sintaksor i kallëzuesit);

Më zien koka – kam hall të madh, jam i shqetësuar (togfjalësh folje + emër - funksioni sintaksor i kallëzuesit);

U ngrinte gjaku – u frikësuan shumë, u tmerruan (togfjalësh folje + emër - funksioni sintaksor i kallëzuesit);

Do të mbytet në gjak – do të përgjaket shumë, nga ndonjë konflikt (togfjalësh folje + emër - funksioni sintaksor i kallëzuesit). Shprehja përdor fjalën “gjakun” si simbol i dhunës dhe tragjedisë, duke krijuar një imazh të fuqishëm.

Nuk ma vinin veshin – s'më dëgjonin, nuk u kushtonin rëndësi fjalëve të mia, nuk i merrnin parasysh ato (togfjalësh i pamotivueshëm - funksioni sintaksor i kallëzuesit);

U hëngrëm një kohë të gjatë – u grindëm një kohë të gjatë, konflikti zgjati shumë (shprehje frazeologjike me strukturë fjalie – funksioni sintaksor i kallëzuesit);

Shumë e lëshon gojën – flet shumë, tepër, pa kontroll (togfjalësh ndajfolje + folje + emër - funksioni sintaksor i kallëzuesit);

Ishin bërë sy e veshë – ishin koncentruar, shihnin e dëgjonin çdo gjë (togfjalësh folje + emër + emër - funksioni sintaksor i kallëzuesit);

E morën vesh – e kuptuan (togfjalësh i pamotivueshëm - funksioni sintaksor i kallëzuesit);

Ballin e turmës – fillimin e turmës, pjesa e parë e një grupi më të madh njerëzish (togfjalësh emër + emër - funksioni sintaksor i kundrines);

I ra të fikët – u alivanos, humbi ndjenjat (togfjalësh i pamotivueshëm - funksioni sintaksor i kallëzuesit);

Kishin marrë fund – ishin shkatërruar, diçka kishte përfunduar pa asnjë mundësi rikuperimi (shprehje frazeologjike me strukturë fjalie – funksioni sintaksor i kallëzuesit);

Po i tregon thonjtë – e tregon veten, shfaq anën negative të tij, e zbulon karakterin e tij të vërtetë (shprehje frazeologjike me strukturë fjalie – funksioni sintaksor i kallëzuesit);

Më ra në sy – u dallua, u bë e dukshme, u vu re (togfjalësh i pamotivueshëm - funksioni sintaksor i kallëzuesit);

Hodha sytë – vështrova, shikova në një drejtim të caktuar (togfjalësh folje + emër - funksioni sintaksor i kallëzuesit);

I ziu ti që s'pe ditë të bardhë – i mjeri ti që s'pe ditë të mirë. Përdoret për të shprehur dhembshuri ndaj dikujt që vazhdimisht ka përjetuar fatkeqësi (shprehje frazeologjike me strukturë fjalie – funksioni sintaksor i kallëzuesit);

Na u dogj shpirti – u mërzitëm, përjetuam dhimbje të thellë (togfjalësh folje + emër - funksioni sintaksor i kallëzuesit);

Po më ngatërroheshin këmbët – nuk mund të shkoj gjëkund se më pengon dikush ose diçka (shprehje frazeologjike me strukturë fjalie – funksioni sintaksor i kallëzuesit);

Kishin rënë në një mendje – kishin të njëjtin mendim, mendonin njëjtë, u pajtuan me mendimin e njëri – tjetrit, arritën marrëveshje (shprehje frazeologjike me strukturë fjalie - funksioni sintaksor i kallëzuesit);

Mbajta këmbët – u ndala, ndërpreva ecjen apo lëvizjen (togfjalësh folje + emër - funksioni sintaksor i kallëzuesit);

Mbeta me gojë hapur – mbeta i mahnitur, u habita, u befasova (shprehje frazeologjike me strukturë fjalie - funksioni sintaksor i kallëzuesit);

E kisha ndër mend gjyshen – e mendoja gjyshen, e kujtoja atë (togfjalësh folje + parafjalë + emër - funksioni sintaksor i kallëzuesit);

Ngul këmbë – këmbëngul, e mbroj mendimin apo vendimin tim (togfjalësh folje + emër - funksioni sintaksor i kallëzuesit);

Kishte varur buzët – u hidhërua, nuk i erdhi mirë, shpreh ndjenjë trishtimi (togfjalësh folje + emër - funksioni sintaksor i kallëzuesit);

U shqye gazit – u shkulëm së qeshuri (togfjalësh folje + emër - funksioni sintaksor i kallëzuesit);

Më plasi shpirtin – më hidhëron shumë (togfjalësh folje + emër - funksioni sintaksor i kallëzuesit);

Sheshi ziente – diçka po ndodhte, atmosfera ishte e gjallë (togfjalësh emër + folje - funksioni sintaksor i kallëzuesit);

Çanë turmën – shkuan përpara, ecën përpara (togfjalësh folje + emër - funksioni sintaksor i kallëzuesit);

Po i kthehej mendja – ndryshoi mendje, filloi të mendojë ndryshe (togfjalësh folje + emër - funksioni sintaksor i kallëzuesit);

Mblidhe veten - eja në vete, kontrollo emocionet, veprimet (togfjalësh folje + përemër - funksioni sintaksor i kallëzuesit);

Shkrumb e hi – u shkrinë, u zhdukën, u shkatërruan krejt (togfjalësh emër + emër - funksioni sintaksor i kallëzuesit);

Prapësia mori dhenë – e keqja ose lajmi i keq u përhap shpejt (togfjalësh emër + folje + emër - funksioni sintaksor i kallëzuesit);

I mbushnin mendjen – e bindnin, përpiqeshin të ndikojnë në mënyrën e të menduarit (togfjalësh folje + emër - funksioni sintaksor i kallëzuesit).

Përfundim

Shprehjet frazeologjike të përdorura në roman paraqesin një pasuri sa sintaksore aq edhe stilistike e semantike, të cilat pasqyrojnë filozofinë e jetës dhe botëkuptimin e personazheve kadareane. Këto shprehje pasqyrojnë traditën e gjatë gojore dhe trashëgiminë e pasur kulturore, duke e lidhur tekstin me origjinën e tij folklorike dhe historike.

Parë në përgjithësi shprehjet frazeologjike të mësipërme mund t'i klasifikojmë në disa kategori:

Sipas strukturës:

Togfjalësha të thjeshtë (folje + emër): Përfshijnë struktura si “E mora vesh” dhe “Ngul këmbë”, që janë të qarta dhe të lehta për t'u deshifruar.

Shprehje frazeologjike me strukturë të përbërë: “I ziu ti që s'pe ditë të bardhë” ose “Prapësia mori dhenë”, janë më komplekse dhe mbartin nuanca kulturore dhe stilistike.

Shprehje idiomatike të pamotivueshme si: “Fjalët i merr era” apo “Ia plasi gazit”, interpretimi i të cilave është më i ndërlikuar.

Sipas kuptimit:

Metaforike: Shprehje si “Shkrumb e hi” dhe “Më plasi shpirtin” sjellin kuptime të thella simbolike që i japin ngjyra diskursit.

Hiperbolike: “U shqye gazit” apo “Mbeta me gojë hapur”, që përforcojnë intensitetin e ndjenjave apo veprimeve.

Përshkruese dhe figurative: “Sheshi ziente” dhe “Çanë turmën” krijojnë një imazh të gjallë në mendjen e lexuesit.

Sipas funksionit sintaksor:

Kallëzues: Shumica e shprehjeve kanë funksionin sintaksor të kallëzuesit (“I mbushnin mendjen,” “Më zien koka”), duke përmbushur rolin kryesor në ndërtimin e fjalive.

Rrethanor: Shprehje si “Një copë herë” dhe “Ishte zhdukur sa hap e mbyll sytë” përdoren për të përcaktuar kohën, mënyrën ose shpejtësinë.

Kundrinor: “Ballin e turmës,” kanë funksion kundrinor duke pasuruar strukturën e fjalive me detaje plotësuese.

Gjuha frazeologjike që Kadare përdor është një përzierje e gjuhës së përditshme, stilit poetik dhe një njohurie të thellë të kulturës dhe traditave shqiptare. Kjo e bën romanin jo vetëm një rrëfim letrar të fuqishëm, por edhe një dëshmi të gjallë të gjuhës shqipe si mjet i ruajtjes dhe transmetimit të trashëgimisë kulturore.

Referencat

- [1]. Abazi, X. (1978). *Vëzhgime kritike* (263-276). Rilindja.
- [2]. Çausi, T. (1993). *Universi letrar i Kadaresë*. Dituria.
- [3]. Grup autorësh. (1980). *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe*. Tiranë.
- [4]. Gjevari, M. (1968). *Frazeologji shqipe*. Rilindja.
- [5]. Ibrahim, M. (2014). *Leksikologji me semantikë*. UEJL.
- [6]. Kadare, I. (2000). *Kronikë në gur*. Onufri.
- [7]. Murati, Q. (2015). *Fjalor i fjalëve dhe shprehjeve nga trojet e shqipes në Maqedoni*. Shkup.
- [8]. Velika, Sh. (2006). *Golem leksikon na stranski zborovi i izrazi*. Shkup.